



Bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionalizimin e qendrave mësimore (tutje në tekst: UA) të aprovuar nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë më datën 7 Dhjetor 2018;

Në përputhje me Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, e cila prezanton vazhdimësinë e politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e të cilat shërbejnë për fuqizimin karakterit multi-etnicitet dhe multi-kulturalizëm në shoqërinë kosovare;

Në përputhje me Deklaratën e Poznani të nënshkruar së fundmi nga partnerët e Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së, në të cilin kryeministrat e Ballkanit Perëndimor ritheksojnë angazhimin e tyre për integrimin e Romëve në shoqëritë tona, si dhe zotohen të rrisin përpjekjet e tyre si pjesë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimit rajonal; dhe

Në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme të Komunës së Vushtrrisë për të përkrahur integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali të përcaktuar në Planin e veprimit lokal të komunës së Vushtrrisë, arrihet kjo:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

OJQ - Terre des hommes Kosovë, përfaqësuar nga znj. Florina Duli Sefaj, Drejtoreshë për Kosovë (referuar më poshtë si "Tdh") dhe

Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës (referuar më poshtë si "Komuna"),

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Përmirësimi i qasjes dhe përfshirja sociale në arsimin fillorë e fëmijëve nga radhët e komuniteteve Romëve, Ashkalinjëve, Egjiptasve dhe grupeve tjera të cenueshme, përfshirë këtu dhe fëmijët e riatdhesuar; promovimi dhe fuqizimi i mbrojtjes së të drejtave të tyre për të siguruar integrimin e tyre të plotë në shoqërinë Kosovare duke pasur parasysh normat e pranuar ndërkombëtarisht të arsimit për të gjithë, të drejtat e fëmijës, mbrojtjen e grupeve të cenueshme në shoqëri dhe promovimin e barazisë gjinore, në kuadër të projektit "Drejtësia Sociale për Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët në Kosovë".

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është menaxhimi institucional i Qendrave Mësimore që deri më tani janë menaxhuar nga Tdh bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.19/2018 mbi Themelimin dhe Funksionalizimin i Qendrave Mësimorete miratuar nga MASHT.

Neni 2

Roli dhe detyrimet e Komunës

Bazuar në nenin 3 të UA ku, parashihet themelimi dhe administrimi i qendrave mësimore nga Komuna, si dhe në nenin 4 të po këtij UA ku, parashihet regjistrimi i qendrave në Ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT).

Bazuar në këtë, Komuna merr përsipër:

2.1. Menaxhimin e qendrave mësimore brenda periudhës kohore prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, dhe atë bazuar në standarde të specifikuar në UA të cekur më lartë duke përfshirë:

- 2.1.1 Përdorimin e hapsirave ekzistuese ose në rast të jopërshtatshmërisë sigurimin e hapsirës më të përshtatshme;
- 2.1.2 Aplikimin e programit ekzistues për mësim plotësues;
- 2.1.3 Kontraktimin e stafit ekzistues;
- 2.1.4 Implementimin e rregullores së punës dhe rregullores për mbrojtjen e fëmijëve si dhe
- 2.1.5 Implementimin e planit të punës dhe planit financiar.

2.2 Regjistrimin e qendrave ekzistuese mësimore menjëherë pas shpalljes së aplikimit për regjistrimin e qendrave mësimore nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë. Qendra mësimore ekzistuese të cila duhet të regjistrohen nga Komuna janë:

- 2.2.1 Qendra mësimore me vend ndodhje në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Andon Zako Çajupi”, Vushtri me gjithsej 3 punëtorë, mësimdhënë, asistentë, tutor etj; dhe
- 2.2.2 Qendra mësimore me vend ndodhje në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Mustafë Venhari”, Vushtri me 2 punëtorë, mësimdhënë, asistentë, tutor etj.

2.3 Të planifikoj dhe zotoj fonde për mbështetjen e qendrave mësimore në planifikimin vjetorë të buxhetit për arsim, bazuar në kërkesat e qendrave mësimore si dhe të planifikojë buxhetin bazë/fillestar për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore me bazë në komunitet dhe me bazë në shkollë, përmes granteve specifike të arsimit.

2.4 Komuna zotohet se gjatë periudhës 3 vjeçare të mbështetjes së vazhdueshme të qendrave dhe do të ndaj raportet narrative dhe financiare të punës së qendrave me organizatës palë në këtë marrëveshje dhe se në afat prej 3 deri 5 muaj do të filloj rekrutimin për staf permanent .

Neni 3

Roli dhe detyrimet e Tdh-së

3.1 Organizata Tdh do të merr përsipër të:

3.1.1 Mbështesin Komunën në përgatitjen e dokumentacionit për aplikim për regjistrim të qendrave mësimore në MASHT;

3.1.2 Mbështesin ngritjen e shkathtësive dhe kapaciteteve të punonjësve të qendrave mësimore dhe Komunës për aplikim sa më të mirë të standardeve të përcaktuara me UA për qendrat mësimore.

3.1.3 Mbështesin Komunën në planifikim të fondeve të nevojshme për operimin e qendrave mësimore gjatë periudhës 3 vjeçare të tranzicionit duke filluar me:

3.1.3.1. Vitin e parë për periudhën:

jan-qershor 2021 me 0% nga Komuna dhe 100% nga Tdh;

shtator-dhjetor 2021 me 75% nga Komuna dhe 25% nga Tdh;

3.1.3.2 Vitin e dytë janar-dhjetor 2022 me 75% nga Komuna dhe 25% nga Tdh

3.1.3.3. Vitin e tretë janar-dhjetor 2023 100% nga Komuna, duke kaluar përgjegjësia e plotë tek Komuna.

3.2 Buxhetin për zbatimin e programit të qendrave mësimore Tdh do të ia transferoj Komunës që do t'i ketë ato në dispozicion për implementim, për të cilin informtata dhe procedurat të dhëna nga Komuna do të specifikohen në aneks.

Neni 4

Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, duke qenë partnerë në koordinimin e të gjitha nismave që do të garantojnë.

Neni 5

Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

Në rast se në mes të palëve të kësaj marrëveshjeje, paraqiten paqartësi apo mos pajtime, palët pajtohen se do të tentojnë t'i zgjidhin përmes bisedimeve.

Neni 6

Ndryshimi/plotësimi i marrëveshjes dhe shkëputja e saj

6.1 Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe/ose të plotësohet, apo të shfuqizohet në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e kësaj marrëveshjeje, apo aktet tjera nënligjore dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë marrëveshje.

6.2 Marrëveshja mund të ripërtërihet, ndryshohet dhe/ose të plotësohet me aneks të veçantë i cili do të jetë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje, në bazë të nevojave dhe zhvillimeve të cilat paraqiten gjatë zbatimit.

6.3 Inicimi i ndërprerjes së marrëveshjes mund të bëhet nga secila palë subjekt i kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit me njoftim paraprak me shkrim, në afat prej tridhjetë (30) ditësh para ndërprerjes dhe/ose zgjidhjes së marrëveshjes. Njoftimi paraprak me shkrim, duhet të përmbajë sqarime të arsyetuara dhe të hollësishme mbi arsyet e ndërprerjes dhe/ose zgjidhjes së marrëveshjes.

6.4 Llogaritja e kohës se njoftimit fillon nga data e pranimit të letrës njoftuese.

Neni 7

Kohëzgjatja

Marrëveshja është e vlefshme deri në arritjen e plotë të transferimit të detyrave dhe përgjegjësisë nga organiza tek Komuna dhe jo më gjatë se 3 vjet nga data e nënshkrimit.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

8.1 Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

8.2 Kjo marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje identike, nga 1 (një) për secilën palë.

Palët nënshkruese

Komuna e Vushtrrisë

_____/_____/2021

Xhafer Tahiri,
Kryetar i Komunës



Terre des hommes

_____/_____/2021

Florina Sefaj
Drejtoreshë për Kosovë

